



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1693/11 prot

Datë 29.10.2021

V E N D I M
K.P.P. 820/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.10.2021 shqyrtoi ankesat me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-94311-04-29-2021, me objekt: “*Blerje kancelari dhe zarfa*”, me fond limit 21.238.515 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

Ankimues: Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK
Rruga “Faik Konica”, Ndërtesa 3, Hyrja 7, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Posta Shqiptare sh.a
Rruga “Reshit Çollaku”, Nr. 4 Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK
Autostrada Tiranë - Durrës, Rruga Dytësore Km 9, Godinë
3 katëshe, Kashar, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.04.2021, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-94311-04-29-2021, me

objekt: “Blerje kancelari dhe zarfa”, me fond limit 21.238.515 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 25.08.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Interlogistic” SHPK	15.974.269,82 lekë	kualifikuar
2. “IT Gjergji Kompjuter” SHPK	17.166.723,77 lekë	kualifikuar
3. “Infosoft” SHPK	20.120.529,11 lekë	kualifikuar

II.3. Në datën 03.09.2021, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) dhe në datë 07.09.2021 është publikuar Njoftimi i fituesit në Buletinin Nr.132, datë 07.09.2021, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, ku rezulton fitues operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.

II.4. Në datën 09.09.2021, operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1693/2 prot., datë 10.09.2021, u publikuan kriteret e kualifikimi, të cilat operatori ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” SHPK pretendon se nuk plotësohen nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.

II.6. Me shkresën nr. 939/25 prot, datë 10.09.2021 me objekt: “Shqyrtim ankesë”, protokolluar me tonën me nr. 1693/3 prot datë 13.09.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik përgjigja e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se e ka refuzuar atë.

II.7. Në datën 15.09.2021, me shkresën nr. 939/26 prot. datë 14.09.2021, protokolluar me tonën me nr. 1693/4 prot., datë 15.09.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Në datën 29.09.2021 me anë të shkresës Nr. 1693/6 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor Posta Shqiptare SHA të dorëzonte pranë KPP-së mostrat e paraqitura në këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.

II.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, në datën 05.10.2021 me anë të shkresës Nr. 1693/7 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi institucionit të Furnizuesit të Shërbimit Universal (OSHEE Group SHA) informacionin si më poshtë: “[...] *Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi dokumentin Nr.6874/1 Prot., datë 27.07.2021 “Vërtetim debie”, të lëshuar nga institucioni juaj, në të cilin janë paraqitur disa kontrata për të cilat deklarohet se subjekti “Interlogistic” SHPK rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime përfshirë faturën koherente të muajit Qershor 2021. Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar si dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 115 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, lind e nevojshme ndihma juaj, nëpërmjet informacionit si më poshtë: A ka subjekti “Interlogistic” SHPK, detyrime të energjisë elektrike të pashlyera, për kontrata të tjera përveç atyre të listuara në dokumentin Nr.6874/1 Prot., datë 27.07.2021 “Vërtetim debie”, të lëshuar nga institucioni juaj, përfshirë detyrimet koherente të muajit Qershor 2021?”*

II.10. Në datën 05.10.2021, me shkresën nr. 1693/8 prot. datë 05.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik, ka vënë në dijeni palët në proces se, referuar nenit 115 pika 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e sipërcituar, nuk është e mundur dalja me një vendim përfundimtar brenda afatit prej 30 ditësh nga ardhja e informacionit të autoritetit kontraktor.

II.11. Në datën 08.10.2021, me shkresën nr. 939/28 prot. datë 07.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1693/9 prot., datë 08.10.2021, me objekt “*Informacion mbi dorëzimin e mostrave për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje kancelari dhe zarfa”*”, autoriteti kontraktor ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik mostrat e paraqitura në këtë procedurë prokurimi nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.

II.12. Me shkresën nr. 8381/1 prot. datë 13.10.2021, protokolluar me tonën me nr. 1693/10 prot., datë 15.10.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik përgjigja e institucionit Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA, i cili informon se: “*Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 1693/7 Prot., datë 05.10.2021, protokolluar me Tonën Nr. 8381 Prot., datë 08.10.2021, ku keni kërkuar informacion mbi detyrimet e energjisë elektrike për kontratat e operatorit ekonomik “Interlogistic” ShPK, ju informojmë si më poshtë vijon: Sipas të dhënave të sistemit tonë të faturimit subjekti “Interlogistic” ShPK është titullar ose përdorues i kontratave bashkëlidhur vërtetimit të debisë nr. Prot. 6874/1, datë 27.07.202 dhe nuk ka detyrime të prapambetura për energjinë elektrike.”*

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK me argumentin se *“Siç duket qartë, OE pjesëmarrës në këtë procedurë, kishin detyrimin që të vërtetonin me dokumentin “skedë teknike, nga prodhuesi i letrës apo distributor i autorizuar” që do të përdoret kartoni me specifikimin e kërkuar, në prodhimin e zarfave të mësipërm EMS. Nga OE Interlogistic, është paraqitur vetëm një material i thjeshtë shkarkuar nga internet, që një prodhues i caktuar, prodhon karton me specifikimin e kërkuar. Çdo përdorues i thjeshtë interneti, mund të shkarkojë një faqe me disa të dhëna, por çfarë lidhje ka ky OE me këtë dokument? Çfarë mundësie ka ky OE të blejë nga kjo fabrikë? Dokumenti ka mungesa të theksuara për ta bërë të vlefshëm, nuk përmban as firmën e as vulën e prodhuesit. Vetëm një dokument i marrë në formë zyrtare, i firmosur dhe vulosur nga prodhuesi, tregon disponibilitetin e tij për të mbështetur dhe furnizuar OE, me produktin e kërkuar. Ky dokument nuk ka asnjë element që mund të vërtetojë një lidhje të OE Interlogistic me prodhuesin në fjalë. Materiali i paraqitur nuk ka as elementet minimale, që e bën atë zyrtar dhe të besueshëm. Nuk ka asnjë adresim në drejtim të OE Interlogistic. Si mund të vërtetojë ky dokument, që do të jetë pikërisht ky karton që do të përdoret në prodhimin e zarfit EMS, objekt prokurimi?! Shkarkimi nga interneti i një faqeje çfaredo, pa asnjë element që ta lidhi atë me OE ofertues apo me prodhuesin e zarfave, s’mund të jetë kurrësi dokument që vërteton plotësimin e parametrin “Trashësia e zarfit, duhet të jetë minimum 250 micron. Zarfat EMS, janë product i një rëndësie të veçantë për AK, por jo më kot është kërkuar vërtetimi i prodhimit me kartonin me specifikën e kërkuar. Dokumenti i paraqitur nga OE Interlogistic nuk ka asnjë element që të vërtetojë këtë. Në këto kushte, OE Interlogistic nuk ka plotësuar kërkesën e AK, për të vërtetuar me anë të një skede teknike të vlefshme, që ka aftësitë për të siguruar një karton për prodhimin e zarfave EMS, me karakteristikat e mësipërme.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“2.3.3 Per zarf kartoni per sherbimin EMS me përmasa 230 x 330mm operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marreveshje bashkëpunimi ose leter angazhimi me firmen prodhuese per mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi.”

III.1.2. Ndërsa në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për mofidifikimin e dokumentave të tenderit, Shtojca 10 “Specifikimet teknike”, për artikullin 29 “Zarfa kartoni për sherbimin EMS 230X330mm”, përcaktohet si më poshtë:

Ishte

29.	<i>Zarfa kartoni për sherbimin EMS 230X330mm</i>	<i>Zarf kartoni për shërbimin EMS me logo dhe xhepore për vendosje të dokumentave shoqëruse me përmasa 230x330mm (23x33cm) me hapje në pjesën e përmasës 330mm, stapmuar logo e shërbimit EMS (Blu me portokalli)</i>
-----	--	---

Bëhet

29.	<i>Zarfa kartoni për sherbimin EMS 230X330mm</i>	<i>Zarf kartoni për shërbimin EMS me logo dhe xhepore për vendosje të dokumentave shoqëruse me përmasa 230x330mm (23x33cm) me hapje në pjesën e përmasës 330mm, stapmuar logo e shërbimit EMS (Blu me portokalli) përmasat e zarfave, janë përcaktuar sipas standartit të përmasave ISO 216, i cili përcakton dhe tolerancat sipas përmasave. Trashësia e zarfit, duhet të jetë minimumi 250 micron. Plotësimi i këtij parametri, të vërtetohet me skedën teknike të prodhuesit të letrës, ose distributorit të autorizuar</i>
-----	--	--

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentin me titull “*Deklaratë prodhuesi/Letër angazhimi*”, datë 25.06.2021 lëshuar nga kompania ”Inpress” SHPK me përmbajtje si vijon: “*...marr përsipër dhe angazhohem të prodhoj dhe furnizoj rregullisht kundrejt kushteve të dakortësuara paraprakisht, shoqërinë “Interlogistic” ShPK., me seli në adresën “Autostrada Tiranë – Durrës, km 9, Kashar, Rruga Dytësore”, Tiranë, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS K21605003M, me të gjithë sasinë që do të mund të nevojitet eventualisht për zbatimin me sukses të kontratës për procedurën e prokurimit publik të lartpërmendur, për*

produktin “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330 mm”, sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST.

Lëndët e para karton / letër që do të nevojiten shoqërisë / shtypshkronjës Inpress ShPK për procesin e prodhimit të sasive të kërkuara, do të furnizohen sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, nga vetë shoqëria Interlogistic ShPK.”

- Dokumentin e emërtuar në SPE ”21_skeda_teknike_grafopak”, të përkthyer dhe të noterizuar, ku pasqyrohen specifikimet teknike të produktit ”karton”.
- Deklaratë Shtojca 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit”

III.1.4. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.5. Në nenin 60 “Përfitimi i origjinës”, të ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Mallrat tërësisht të përfutuara në një vend ose territor të vetëm konsiderohen të kenë origjinën e atij vendi ose territori.

2. Mallrat, prodhimi i të cilave përfshin më shumë se një vend ose territor, konsiderohen origjinuese në vendin ose territorin ku kanë pësuar ndryshimin ose përpunimin e tyre të fundit, thelbësor e të justifikuar ekonomikisht, në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim e që rezulton në prodhimin e një produkti të ri ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit.

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.7. Sa më sipër nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, për procedurën objekt ankimi, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar shprehimisht që për produktin zarf kartoni për shërbimin EMS me përmasa 230 x 330 mm operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhuese për mallin objekt prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Interlogistic” ShPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit KPP konstaton, se ky i fundit, ka dorëzuar dokumentin “*Deklaratë prodhuesi/Letër angazhimi*”, datë 25.06.2021 lëshuar nga kompania “Inpress” SHPK, i cili merr përsipër të prodhoj dhe furnizoj rregullisht kundrejt kushteve të dakortësuara paraprakisht, shoqërinë “Interlogistic” ShPK., me të gjithë sasinë që do të mund të nevojitet eventualisht për zbatimin me sukses të kontratës për procedurën e prokurimit publik të lartpërmendur, për produktin “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330 mm”, sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST.” Gjithashtu, në këtë deklaratë citohet se “Lëndët e para karton / letër që do ti nevojiten shoqërisë / shtypshkronjës Inpress ShPK për procesin e prodhimit të sasive të kërkuara, do të furnizohen sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, nga vetë shoqëria Interlogistic ShPK.”

Pra, në rastin konkret, KPP gjykon se operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK ka përmbushur kriterin e kualifikimit në pikën 2.3.3. të “Kapacitetit teknik”, duke paraqitur dokumentin me anë të të cilit vërteton se për produktin “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230 X 330 mm”, do të furnizohet nga prodhuesi “Inpress” SHPK. Pra, operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK ka dorëzuar një dokument sipas kërkesave të përcaktuara nga autoritetit kontraktor në kriteret e kualifikimit.

Në nenin 60 të ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Mallrat tërësisht të përfutuara në një vend ose territor të vetëm konsiderohen të kenë origjinën e atij vendi ose territori. 2. Mallrat, prodhimi i të cilave përfshin më shumë se një vend ose territor, konsiderohen origjinuese në vendin ose territorin ku kanë pësuar ndryshimin ose përpunimin e tyre të fundit, thelbësor e të justifikuar ekonomikisht, në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim e që rezulton në prodhimin e një produkti të ri ose që përfaqëson një fazë të rëndësishme të prodhimit.” Pra në rastin, konkret legjislacioni në asnjë moment nuk ndalon operatorët ekonomik që produktet që ata ofrojnë të jenë me origjinë shqiptare.

Për sa i përket pretendimit të ankimuesit, se operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK nuk ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor, për të vërtetuar me anë të një skede teknike të vlefshme, që ka aftësinë për të siguruar një karton për prodhimin e zarfave EMS, KPP gjykon se, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit, ndonjë kërkesë në lidhje me *Skedën teknike për produktin Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230 X 330 mm*, ndaj paraqitja apo

mosparaqitja e tij nuk mund të përbëjë shkak për kualifikimin/skualifikimin e një operatori ekonomik.

Sa më sipër, KPP gjykon se, se kërkesa e autoritetit kontraktor për dorëzimin e *Skedës teknike për produktin Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230 X 330 mm*, nuk është vendosur nga ana e autoritetit kontraktor në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, të cilat janë të detyrueshme për tu plotësuar nga operatorët ekonomikë, në mënyrë që autoriteti kontraktor të verifikojë kapacitetin e tyre ligjor, profesional, ekonomik dhe teknik, por kërkesa për dorëzimin e skedës teknike për produktin *Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230 X 330 mm* është vendosur në shtojcën 10 “Specifikimet teknike”, ku referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik specifikimet teknike përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen dhe duhet të përgatiten nga autoriteti kontraktor për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit. Në rastin në shqyrtim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar *Skedë teknike*, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, rrjedhimisht, autoriteti kontraktor nuk mund të vlerësojë mbi kritere të cilat nuk janë kërkuar nga ana e tij. Për përmbushjen e specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka parashikuar plotësimin e shtojcës 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit”, deklaratë kjo e cila është plotësuar dhe është paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK në këtë procedurë prokurimi, është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK me arsyetimin se: *“Formulari i ofertës, paraqitur nga OE Interlogistic SHPK, nuk është plotësuar në formën e duhur, që kërkon ligji. Në vend të “Afatit” të lëvrimit 45 ditë kërkuar nga AK, OE ka vendosur 150 ditë që përkon me “Periudhën e vlefshmërisë së ofertës”, pra, asnjë lidhje me Afatin, duke mos plotësuar kështu kërkesën e AK për lëvrim brenda 45 ditëve. Formulari i ofertës është rigorozisht i përcaktuar në DST dhe mosplotësimi i tij sipas ligjit dhe kërkesës së AK, është kusht për skualifikim. Kualifikimi i OE Interlogistic, i cili në mënyrë flagrante nuk ka plotësuar kërkesën e AK mbi afatin e lëvrimit, i vendos OE pjesëmarrës në kushte të pabarabarta, duke shkelur LPP, neni 2 dhe neni 3, mbi barazinë e pjesëmarrësve.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i ofertës” pika 1.1. përcaktohet: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në*

përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.”

Ndërsa në pikën 1.6. përcaktohet: “Oferta duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:

a) Formulari i Ofertës, plotësuar sipas Shtojcës 1 të DT ose Shtojcës 2 të DT (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje).“.

III.2.2. Në dokumentet e tenderit, “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 2 “Përlllogaritja e ofertës ekonomike” pika 2.1. përcaktohet: “Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkëngjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të lëvrohen, sasi të dhe çmimin e tyre.”

III.2.3. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 1 “Formulari i ofertës ekonomike”, është përcaktuar:

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i mallrave	Sasia	Çmimi Njësi	Çmimi Total	Afati
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.2.4. Ndërkohë në shtojcën 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit”, përcaktohet:

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e _____ të personit juridik _____ deklaroj se:

Përmbushim të gjitha specifikimet teknike, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe e vërtetojmë këtë me certifikata e dokumente (nëse kërkohe nga autoriteti kontraktor), të dorëzuar bashkë me këtë deklaratë si dhe marrim përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

III.2.5. Në dokumental e tenderit, “Njoftimi i kontratës”, Seksioni 1 “Autoriteti kontraktor” pika 2.9. dhe 4.5 përcaktohet:

2.9 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj □□□ ose ditë 45 ditë

4.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave: 150 (e shprehur në ditë)

III.2.6. Në shtojcën 12 “Sasia dhe Grafiku i lëvrimit”, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Afatet e lëvrimit: Malli do të dorëzohet brenda 45 (dyzet e pese) diteve kalendarike nga dita e nënshkrimit të kontratës mes paleve.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (S.P.E) nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

1. Formulari i ofertës, në të cilin pasqyrohen Emri i ofertuesit; Autoriteti kontraktor; Lloji i procedurës së prokurimit; Objekti i prokurimit; Çmimi total i ofertës pa TVSH; Çmimi total i ofertës me TVSH; Përshkrimi i mallrave; Njësia; Sasia; Çmimi njësi pa TVSH; Çmimi total; Afati i vlefshmërisë së ofertës; nënshkrimi dhe vula e ofertuesit.

2. Deklaratë e operatorit ekonomik “Interlogistic”, datë 09.08.2021, nr. Prot 5041200255, e plotësuar sipas Shtojca 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit”.

III.2.8. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë, se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, në pjesën “Udhëzime për operatorët ekonomikë” përcaktohet “*Operatori Ekonomik duhet të plotësojë Formularin e Ofertës bashkëngjitur me këto DT, duke përcaktuar mallrat që do të lëvrohen, sasinë dhe çmimin e tyre*“. Gjithashtu autoriteti kontraktor në këto dokumente ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë formularin e ofertës sipas tabelës në Shtojcën, ku në këtë tabelë kërkohet të paraqitet vlera totale e ofertës (pa/me Tvsh), përshkrimi i mallrave, sasia, çmimi njësi, çmimi total si dhe afati. Ndërkohë, në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” dhe në shtojcën 10 “Sasia dhe grafiku i lëvrimit” janë përcaktuar qartë mallrat që kërkohen nga autoriteti kontraktor sasia dhe afati i lëvrimit të tyre. KPP thekson se, referuar objektit dhe natyrës të kësaj procedure prokurimi, kemi të bëjmë me një kontratë për lëvrimin e mallrave të caktuar, ku nga ana e autoritetit kontraktor në cilësinë e “blerësit” është përcaktuar qartë lloji, sasia dhe afati i lëvrimit të tyre, kështu që rrjedhimisht edhe operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët pretendojnë fitimin e kontratës, kanë detyrimin që të paraqesin në ofertën e tyre të dhënat lidhur me produktet që ofrojnë, duke përcaktuar qartë llojin e produktit, sasinë, vlerën për secilin produkt si dhe afatin e lëvrimit të tyre.

Sa më sipër, nga shqyrtimi ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, KPP konstaton, se ky i fundit ka paraqitur formularin e ofertës, duke përcaktuar vlerën totale të kontratës pa TVSH dhe vlerën totale të kontratës me TVSH, si dhe artikujt e kërkuar; njësinë; sasinë; çmimin për njësi pa TVSh dhe çmimin total për çdo artikull në përputhje me sasinë e kërkuar, duke përmbushur kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit si dhe detyrimet ligjore të përcaktuara për prokurimin publik.

Për sa i përket afatit të përcaktuar në formularin e ofertës, ku operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK në formularin e ofertës të paraqitur prej tij ka pasqyruar afatin e vlefshmërisë së ofertës prej 150 ditësh, gjykojmë se, referuar objektit dhe natyrës të kësaj procedure prokurimi, kemi të bëjmë me një kontratë për lëvrimin e mallrave të caktuar, ku nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar qartë afati i lëvrimit të mallrave brenda 45 ditëve nga dita e lidhjes së kontratës dhe për përmbushjen e këtij kriteri autoriteti kontraktor ka kërkuar gjithashtu nga operatorët ekonomikë plotësimin e Shtojcës 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe

realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit”. Operatori ekonomik ”Interlogistic” SHPK në lidhje me vërtetimin e përmbushjes së afatit të lëvrimit të mallit, ka paraqitur Shtojcën 6 ”Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit”, duke deklaruar se merr përsipër realizimin e objektit sipas grafikut të lëvrimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 12 të dokumenteve të tenderit, duke përmbushur kështu kërkesën e autoritetit kontraktor, si dhe duke vërtetuar faktin se lëvrimi i mallit do të bëhet brenda 45 ditëve, sic kërkohet në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, KPP konstaton se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK përmbush kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, me argumentin se: “*OE Interlogistic nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, për të gjitha pikat e ushtrimit të aktivitetit të saj. Mosplotësimi i këtij kushti, përbën arsye për skualifikim*”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 9 “*Kriteret e Veçanta për Kualifikim*” pika 1 gërma “e” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (S.P.E) nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon:

- *Vërtetim debie nr. 6874/1 prot., datë 27.07.2021, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. X. X, vërtetohet se kërkuesi Interlogistic SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën /kontratat (me kod), titullar / përdorues i së cilës/ave është Interlogistic ShPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 26.07.2021 përfshirë faturën koherente të muajit Qershor 2021.*

Bashkëlidhur këtij dokumenti është paraqitur një listë me kontratat ku është titullar ose përdorues subjekti “Interlogistic” SHPK.

III.3.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.3.4. Në nenin 134 “Dispozita kalimtare” të ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar:

1. Procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji vijnë të realizohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.
2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

III.3.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma “c”, përcaktohet se: “Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e paguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.

III.3.6. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr.109, datë 21.10.2011 të ERE “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, konstaton se ky i fundit në përmbushje të kriterit në lidhje me vërtetimin e shlyerjes së energjisë elektrike, ka paraqitur Vërtetim debie nr. 6874/1 prot., datë 27.07.2021, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. X. X, vërtetojmë se kërkuesi Interlogistic SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën /kontratën (me kod), titullar / përdorues i së cilës/ave është Interlogistic shpk, rezulton të ketë në

total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 26.07.2021 përfshirë faturën koherente të muajit Qershor 2021. Gjithashtu, bashkëlidhur këtij dokumenti është paraqitur një listë me kontratat ku është titullar ose përdorues subjekti “Interlogistic” SHPK, i gjeneruar nga sistemi i faturimit datë 26.07.2021. Pra, nëpërmjet këtij vërtetimi verifikohet se operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, nuk rezulton debitor pranë Furnizuesit të Shërbimit Universal SHA, duke përfshirë faturën koherente të muajit Qershor.

Për këtë arsye, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, me qëllim shqyrtimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, KPP iu drejtua Furnizuesit të Shërbimit Universal (OSHEE Group SHA), si institucioni përgjegjës, nëpërmjet shkresës Nr. 1693/7 prot., ku i kërkoi informacionin si më poshtë: “[...] Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi dokumentin Nr.6874/1 Prot., datë 27.07.2021 “Vërtetim debie”, të lëshuar nga institucioni juaj, në të cilin janë paraqitur disa kontrata për të cilat deklarohet se subjekti “Interlogistic” SHPK rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime përfshirë faturën koherente të muajit Qershor 2021. Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar si dhe në zbatim të pikës 5 të nenit 115 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, lind e nevojshme ndihma juaj, nëpërmjet informacionit si më poshtë: A ka subjekti “Interlogistic” SHPK, detyrime të energjisë elektrike të pashlyera, për kontrata të tjera përveç atyre të listuara në dokumentin Nr.6874/1 Prot., datë 27.07.2021 “Vërtetim debie”, të lëshuar nga institucioni juaj, përfshirë detyrimet koherente të muajit Qershor 2021?”.

Ndërkohë, Furnizuesi i Shërbimit Universal (OSHEE Group SHA) i ka kthyer përgjigje kërkesës tonë duke informuar se: “Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 1693/7 Prot., datë 05.10.2021, protokolluar me Tonën Nr. 8381 Prot., datë 08.10.2021, ku keni kërkuar informacion mbi detyrimet e energjisë elektrike për kontratat e operatorit ekonomik “Interlogistic” ShPK, ju informojmë si më poshtë vijon: Sipas të dhënave të sistemit tonë të faturimit subjekti “Interlogistic” ShPK është titullar ose përdorues i kontratave bashkëlidhur vërtetimit të debisë nr. Prot. 6874/1, datë 27.07.202 dhe nuk ka detyrime të prapambetura për energjinë elektrike.”

III.3.8. Sa më sipër, referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Furnizuesin e Shërbimit Universal (OSHEE Group SHA), konstatohet se, referuar deklarimeve të këtij të fundit, subjekti “Interlogistic” SHPK është titullar ose përdorues i kontratave bashkëlidhur vërtetimit të debisë nr. Prot. 6874/1, datë 27.07.2021 (dokument i dorëzuar në SPE), dhe nuk ka detyrime të prapambetura të energjisë elektrike.

KPP gjykon, se Furnizuesi i Shërbimit Universal (OSHEE Group SHA) është institucioni i ngarkuar me akt nënligjor për lëshimin e vërtetimit të debisë për personat fizikë dhe juridikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, kështu që rrjedhimisht, referuar korrespondencës zyrtare të Komisionit të Prokurimit Publik me Furnizuesin e Shërbimit Universal (OSHEE Group SHA), operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK rezulton 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, për të gjitha kontratat ku ky operator është titullar ose përdorues.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, me argumentin se: *“Sipas DST, në tender, duhej të paraqiteshin mostra për disa artikuj dhe midis të tjerave edhe për artikullin nr. 16, “Dosje me mekanizëm”, me specifikim: “Dosje me mekanizëm 8 cm me kuti, kutia të jetë me karton të fortë me xhep anësorë për vendosje etiketë në gjerësi anash, me ngjyra të ndryshme mekanizmi me kapse brenda metalike.” Në bazë të specifikimit të mësipërm, dosja duhet të ishte me kuti dhe kutia në faqen anësore, duhet të kishte një xhep. Mostra e OE Interlogistic, nuk kishte xhep në kutinë, në faqen anësore, por kishte xhep në trupin e dosjes. Pranimi i këtij artikulli, megjithëse nuk plotësonte specifikimet teknike, i vendos OE, në kushte të pabarabarta, pasi gjetja e këtij produkti specifik, kishte një kosto dhe vështirësi të lartë. Toleranca të tilla në mosplotësimin e specifikimeve teknike, krijojnë konfuzion dhe padrejtësi ndërmjet OE, disa prej të cilëve, ndoshta nuk kanë kuotuar edhe vetëm sepse nuk kanë siguruar dot këtë artikull. Specifikimet teknike janë kusht i domosdoshëm për tu plotësuar dhe mosplotësimi i tyre përbën kusht për skualifikim. Mosplotësimi i specifikimit teknik të art.16, ishte diçka që shihej lehtësisht në sy të lirë, ndërkohë që në listën e mostrave, ishte dhe art. 48, 52, 59 dhe 62, të cilat kishin specifikime dhe ndryshonin vetëm nga përmasat. Megjithë këmbënguljen tonë që të mateshin taskinat nga ana e komisionit të vlerësimit të ofertave mbi marrjen në dorëzim të mostrave, nuk u mor parasysh kjo kërkesë dhe u konsideruan të rregullta mostrat e paraqitura. Kërkojmë të bëhet verifikimi i përmasave të këtyre artikujve, pasi kemi dyshime të forta që nuk plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara nga AK.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt 1, 2, 3, 5, 6, 15, 16, 17, 18, 19, 24, 28, 29, 35, 36, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 48, 52, 59, 62, 64, 71, 72, të kërkuar sipas listës së artikujve ne Shtojcën 12, Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.”

III.4.2. Ndërsa në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Shtojca 10 “Specifikimet teknike”, përcaktohet si më poshtë:

16.	Dosje me mekanizem	<i>Dosje me mekanizëm 8cm me kuti, kutia të jetë me karton të fortë me xhep anësorë për vendosje etiketë në gjerësi anash, me ngjyra të ndryshme mekanizmi me kapse brenda metalike.</i>
-----	--------------------	--

48.	Taskina plastike për pullat postare 34x44	Taskina është një xhep , material Polistiren me trashësi minimumi 130 micron të dy fletët bashkë. I tejudkshëm. Taskina është një mbajtëse pulle me dy pjesë e me material polisteren të tejudkshëm. Njëra anë e tejudkshme është me ngjitës i cili po të laget me ujë ngjitet, ndërsa ana tjetër e tejudkshme me qëllim paraqitjen dhe ruajtjen e pullës. Si bazë do të merret përmasa e parë dmth 34mm dhe do të jetë e mbyllur.
-----	---	--

52.	Taskina plastike për pullat postare 74x94	Taskina është një xhep , material Polistiren me trashësi minimumi 130 micron të dy fletët bashkë. I tejudkshëm. Taskina është një mbajtëse pullë me dy pjesë e me material polisteren të tejudkshëm. Njëra anë e tejudkshme është me ngjitës i cili po të laget me ujë ngjitet, ndërsa ana tjetër e tejudkshme me qëllim paraqitjen dhe ruajtjen e pullës. Si bazë do të merret përmasa e parë dmth 74mm dhe do të jetë e mbyllur.
-----	---	--

59.	Taskina plastike për zarfin e ditës së parë (FDC) 184x104	Taskina është një xhep, material Polistiren, me trashësi minimum 130micron të dy fletët bashkë. I tejudkshëm. Taskina është një mbajtëse pullë me dy pjesë e me material polietilen të tejudkshëm për ruajtjen e zarfit të ditës së parë (FDC). Si bazë do të merret përmasa e parë dmth 184mm
62.	Taskina plastike për pullat postare 119x74	Taskina është një xhep , material Polistiren me trashësi minimumi 130 micron të dy fletët bashkë. I tejudkshëm. Taskina është një mbajtëse pullë me dy pjesë e me material polisteren të tejudkshëm. Njëra anë e tejudkshme është me ngjitës i cili po të laget me ujë ngjitet, ndërsa ana tjetër e tejudkshme me qëllim paraqitjen dhe ruajtjen e pullës. Si bazë do të merret përmasa e parë dmth 119mm dhe do të jetë e mbyllur..

Shënim: Produkti Taskine (Ose xhepore) është një produkt që përdoret nga koleksionistët e pullave postare dhe materialeve filatelike. Ky është një term që njihet dhe përdoret ndërkombëtarisht. Operatorët ekonomik mund të hyjnë në ëbsite e kompanive të huaja, që tregtojnë këto produkte, pasi ky produkt nuk prodhohet në vend por vetëm importohet. Për ilustrim po paraqesim pamje të një modeli si më poshtë.

Gjithashtu, në shtojcën “Njoftim_modifikimi Kancelari” të publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit, është publikuar sqarimi si më poshtë:

“Sqarim:

Lidhur me artikujt Taskina:

Taskina, është një terminologji teknike dhe pikërisht për ta kuptuar, kemi dhënë specifikime tepër të hollësishme që përshkruajnë produktin. Gjithsesi, çdo operator ekonomik i interesuar, mund të paraqitet pranë pranë Drejtorisë së Përgjithshme Posta Shqiptare SHA., për të parë një mostër fizike të tyre.

Lidhur me përmasat, ju sqarojmë që është e një rëndësie të veçantë plotësimi i tyre, pasi lidhen drejtpërsëdrejti me përmasat e pullave të cilat janë të mirëpërcaktuara dhe që duhet të rrinë fiks në taskinë. Ju sigurojmë që materiali e lejon plotësisht precizionin.”

III.4.3. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.4. Neni 36 “Specifikimet teknike” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet

ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.4.5. Në nenin 134 “Dispozita kalimtare” të ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar:

1. Procedurat e nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji vijojnë të realizohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Çdo akt tjetër nënligjor, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

III.4.6. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimitdhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.4.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.4.8. Referuar kritereve të veçanta të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt 1, 2, 3, 5, 6, 15, 16, 17, 18, 19, 24, 28, 29, 35, 36, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 48, 52, 59, 62, 64, 71, 72, të kërkuar sipas listës së artikujve ne Shtojcën 12. Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim.

III.4.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, informacionit të autoritetit kontraktor si dhe nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, KPP konstatoi se ky i fundit për artikullin nr.16 “*Dosje me mekanizëm*”, ka paraqitur mostër, dosje me mekanizëm me kapëse metalikë, me kuti me karton të fortë, ngjyrë të bardhë, e cila ka një xhep anësor për vendosje etikete në gjerësi anash dosjes.

Ndërkohë për artikullin Nr. 48 “Taskina plastike për pullat postare 34x44”, artikullin Nr. 52 “Taskina plastike për pullat postare 74x94”, artikullin Nr.59 “Taskina plastike për zarfin e ditës së parë (FDC) 184x104” dhe artikullin nr. 62 “Taskina plastike për pullat postare 119x74”, operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, ka dorëzuar mostrat sipas përmasave të përcaktuara në specifikimet teknike.

III.4.10. Komisioni i Prokurimit Publik, pas verifikimit të mostrave të dorëzuara pranë tij nga ana e autoritetit kontraktor, konstatoi se artikujt nr.16 “*Dosje me mekanizëm*”, nr. 48 “Taskina plastike për pullat postare 34x44”, nr. 52 “Taskina plastike për pullat postare 74x94”, artikullin nr.59 “Taskina plastike për zarfin e ditës së parë (FDC) 184x104” dhe artikullin nr. 62 “Taskina plastike për pullat postare 119x74”, të dorëzuara nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK. janë në përputhje me specifikimet teknike dhe kërkesat e autoritetit kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, pasi mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, kanë të gjitha specifikat e kërkuara nga autoriteti kontraktor (përmasat, materiali etj). Për këtë arsye, KPP gjykon se mostrat e artikujve të paraqitura nga operatori ekonomik janë në përputhje me specifikimet teknike dhe parametrat e kërkuara nga autoriteti kontraktor.

III.4.11. KPP thekson, se kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor, për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht, ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të përcaktuar në dokumentet e tenderit përbën shkak për skualifikim. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara. Në rastin konkret, mostrat e artikujve të paraqitura nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara nga autoriteti kontraktor, e për rrjedhojë ky operator ekonomik përmbush kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-94311-04-29-2021, me objekt: “Blerje kancelari dhe zarfa”, me fond limit 21.238.515 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

Jonaid
Myzyri

Digitally signed by
Jonaid Myzyri
Date: 2021.11.01
04:35:39 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik z. Kreshnik Ternova (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtar i KPP-së shpreh mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, konkretisht nuk jam dakord me arsyetimin në pikën III.1 e në vijim, si dhe dispozitivin e vendimit për sa i përket çështjes me

Objekt: “Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-94311-04-29-2021, me objekt: “Blerje kancelari dhe zarfa”, me fond limit 21.238.515 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.”

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK me argumentin se “Siç duket qartë, OE pjesëmarrës në këtë procedurë, kishin detyrimin që të vërtetonin me dokumentin “skedë teknike, nga prodhuesi i letrës apo distributor i autorizuar” që do të përdoret kartoni me specifikimin e kërkuar, në prodhimin e zarfave të mësipërm EMS. Nga OE Interlogistic, është

paraqitur vetëm një material i thjeshtë shkarkuar nga internet që një prodhues i caktuar, prodhon karton me specifikimin e kërkuar. Çdo përdorues i thjeshtë interneti, mund të shkarkojë një faqe me disa të dhëna, por çfarë lidhje ka ky OE me këtë dokument? Çfarë mundësie ka ky OE të blejë nga kjo fabrikë? Dokumenti ka mungesa të theksuara për ta bërë të vlefshëm, nuk përmban as firmën e as vulën e prodhuesit. Vetëm një dokument i marrë në formë zyrtare, i firmosur dhe vulosur nga prodhuesi, tregon disponibilitetin e tij për të mbështetur dhe furnizuar OE, me produktin e kërkuar. Ky dokument nuk ka asnjë element që mund të vërtetojë një lidhje të OE Interlogistic me prodhuesin në fjalë. Materiali i paraqitur nuk ka as elementët minimal që e bën atë zyrtar dhe të besueshëm. Nuk ka asnjë adresim në drejtim të OE Interlogistic. Si mund të vërtetojë ky dokument, që do të jetë pikërisht ky karton që do të përdoret në prodhimin e zarfit EMS, objekt prokurimi?! Shkarkimi nga internet i një faqeje çfarëdo, pa asnjë element që ta lidhi atë me OE ofertues apo me prodhuesin e zarfave, s'mund të jetë kurrësi dokument që vërteton plotësimin e parametrin "Trashësia e zarfit, duhet të jetë minimum 250 micron. Zarfat EMS, janë produkt i një rëndësie të veçantë për AK por jo më kot është kërkuar vërtetimi i prodhimit me kartonin me specifikën e kërkuar. Dokumenti i paraqitur nga OE Interlogistic nuk ka asnjë element që të vërtetojë këtë. Në këto kushte, OE Interlogistic nuk ka plotësuar kërkesën e AK, për të vërtetuar me anë të një skede teknike të vlefshme, që ka aftësitë për të siguruar një karton për prodhimin e zarfave EMS, me karakteristikat e mësipërme.", vërej,

III.1.1. Në shtojcën 9 "Kriteret e veçanta të kualifikimit", pika 2.3.3 "Kapaciteti teknik", të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

"2.3.3 Për zarf kartoni për shërbimin EMS me përmasa 230 x 330mm operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt-marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhuese për mallin objekt-prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi."

III.1.2. Ndërsa në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Shtojca 10 "Specifikimet teknike", për artikullin 29 "Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330mm", përcaktohet si më poshtë:

Ishte

29.	Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330mm	Zarf kartoni për shërbimin EMS me logo dhe xhepore për vendosje të dokumenteve shoqëruese me përmasa 230x330mm (23x33cm) me hapje në pjesën e përmasës 330mm, stampuar logo e shërbimit EMS (Blu me portokalli)
-----	---	---

Bëhet

29.	Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330mm	Zarf kartoni për shërbimin EMS me logo dhe xhepore për vendosje të dokumenteve shoqëruese me përmasa 230x330mm (23x33cm) me hapje në pjesën e përmasës
-----	---	--

		<p>330mm, stampuar logo e shërbimit EMS (Blu me portokalli)</p> <p>përmasat e zarfave, janë përcaktuar sipas standardit të përmasave ISO 216, i cili përcakton dhe tolerancat sipas përmasave. Trashësia e zarfit, duhet të jetë minimumi 250 micron. Plotësimi i këtij parametri, të vërtetohet me skedën teknike të prodhuesit të letrës, ose distributorit të autorizuar</p>
--	--	---

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentin me titull “*Deklaratë prodhuesi/Letër angazhimi*”, datë 25.06.2021 lëshuar nga kompania ”Inpress” SHPK me përmbajtje si vijon: “...marr përsipër dhe angazhohem të prodhoj dhe furnizoj rregullisht kundrejt kushteve të dakortësuara paraprakisht, shoqërinë “Interlogistic” ShPK., me seli në adresën “Autostrada Tiranë – Durrës, km 9, Kashar, Rruga Dytësore”, Tiranë, regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS K21605003M, me të gjithë sasinë që do të mund të nevojitet eventualisht për zbatimin me sukses të kontratës për procedurën e prokurimit publik të lartpërmendur, për produktin “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330 mm”, sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST.
Lëndët e para karton / letër që do ti nevojiten shoqërisë / shtypshkronjës Inpress ShPK për procesin e prodhimit të sasive të kërkuara, do të furnizohen sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, nga vetë shoqëria Interlogistic ShPK.”
- Dokumentin e emërtuar në SPE ”21_skeda_teknike_grafopak”, të përkthyer dhe të noterizuar.

III.1.4. Në nenin Neni 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses

të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.6. Sa më sipër nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, për procedurën objekt-ankimi, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.3 të “Kapacitetit teknik” ka kërkuar shprehimisht, që për produktin zarf kartoni për shërbimin EMS me përmasa 230 x 330 mm, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese ose akt-marrëveshje bashkëpunimi ose letër angazhimi me firmën prodhuese për mallin objekt-prokurimi ose nga distributori i autorizuar nga Prodhuesi.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Interlogistic” ShPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, KPP konstaton se ky i fundit, ka dorëzuar dokumentin “*Deklaratë prodhuesi/Letër angazhimi*”, datë 25.06.2021 lëshuar nga kompania “Inpress” SHPK, i cili “*merr përsipër të prodhojë dhe furnizojë rregullisht kundrejt kushteve të dakortësuara paraprakisht, shoqërinë “Interlogistic” ShPK., me të gjithë sasinë që do të mund të nevojitet eventualisht për zbatimin me sukses të kontratës për procedurën e prokurimit publik të lartpërmendur, për produktin “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330 mm”, sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST*”. Në këtë deklaratë citohet gjithashtu se “*Lëndët e para karton / letër që do ti nevojiten shoqërisë / shtypshkronjës Inpress ShPK për procesin e prodhimit të sasive të kërkuara, do të furnizohen sipas karakteristikave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në DST, nga vetë shoqëria Interlogistic ShPK.*” Sa më sipër, nga dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, konstatohet se shoqëria “Inpress” SHPK do të furnizojë operatorin ekonomik “Interlogistic” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me produktin “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330 mm”, **por lënda e parë (karton/letër) për prodhimin e këtyre zarfave do të ofrohet nga vetë operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK.**

Sa më sipër, referuar dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK në përmbushje të kriterit në lidhje me artikullin “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330 mm”, konkretisht deklaratës të lëshuar nga shoqëria “Inpress” SHPK, konstatohet se kjo e fundit mund të prodhojë artikuj të ndryshëm, ndër to dhe artikullin objekt-ankimi, por në asnjë moment nuk garantohej, se ky produkt do të prodhohet në cilësi dhe sipas specifikimeve teknike të

përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi lënda e parë e prodhimit (karton/letër) nuk ofrohet nga shoqëria “Inpress” SHPK.

Shoqëria “Inpress” SHPK në tejkallim të kompetencave teknike, ka lëshuar një deklaratë e cila nuk i shërben qëllimit për të vërtetuar përmbushjen e kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor, pasi sipas kësaj deklarate nga shoqëria “Inpress” SHPK garantohet ofrimi i produktit “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330 mm”, sipas lëndës së parë me specifikime teknike të ofruar nga vetë operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit “Interlogistic” SHPK, i cili nuk ka paraqitur asnjë dokument provues, të vlefshëm për vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike.

Sa më sipër argumentuar, gjykoj se, për sa kohë referuar deklaratës së shoqërisë “Inpress” SHPK, lënda e parë (karton/letër) për prodhimin e produktit “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330 mm” do të ofrohet nga vetë operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, rrjedhimisht është detyrë e këtij të fundit, që për lëndën e parë që do të ofrojë për prodhimin e zarfave EMS, të vërtetojë përmbushjen e specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor për këtë produkt. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Publik nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur, një skedë teknike të përkthyer “Fabrika Kolicveo Karton d.o.o Proizvodnja kartona d.o.o Slloveni – Grafopak – Kodi nr. 42134 – Gra/GD2”, për të cilën nuk ka arsyetuar dhe nuk ka paraqitur asnjë fakt dhe provë, e cila vërteton lidhjen midis operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK dhe prodhuesit që ka lëshuar këtë skedë teknike.

Sa më sipër, gjykoj se, me dokumentacionin e paraqitur operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, në asnjë moment nuk vërteton se mund të ofrojë produktin “Zarfa kartoni për shërbimin EMS 230X330 mm”, sipas të gjitha parametrave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, gjykoj, se referuar arsytimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Si rrjedhojë e arsytimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 34, 46 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, gjykoj:

- Të pranohet ankesa e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-94311-04-29-2021, me objekt: “*Blerje kancelari dhe zarfa*”, me fond limit 21.238.515 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 09.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.
- Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.

Anëtar

Kreshnik Ternova